

**THE RECEPTION OF JEAN-PAUL SARTRE IN NORTH
MACEDONIA: A CULTURAL ENCOUNTER AND INTELLECTUAL
INFLUENCE**

**RECEPTIMI I JEAN-PAUL SARTRE-IT NË MAQEDONINË E
VERIUT: NJË TAKIM KULTUROR DHE NDARJE INTELEKTUALE**

Dëfrim SALIU¹, Shejnaze AJDINI-MURTEZI²

¹ Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

² Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians - Skopje

*Corresponding author e-mail: defrim.saliu@unite.edu.mk

Abstract

Jean-Paul Sartre, as a leading representative of French existentialism, began to be read and analyzed by literary critics and scholars in the Republic of North Macedonia after the publication of their works in Serbian and later in Macedonian. The reception started with Sartre's most famous novel *Nausea* beginning in 1966. Subsequently, his works were translated, including *Words*, *The Condemned of Altona*, *Dirty Hands* and *Being and Nothingness*. Over a dozen scholarly works discuss Sartre's life and literary-philosophical work, providing a deep insight into his treatment within the Macedonian cultural system. The reception of Sartre's philosophy in North Macedonia has had a profound influence on the country's academic and cultural world. Through translations of his works and extensive analyses made about his life and work, Sartre has become one of the key figures in literary and philosophical studies in Macedonia.

Through these studies, a true enlightenment has been offered on the interpretation of his thought and his influence on Macedonian society. In addition to his literary works, Sartre is also known for his political engagement and his influence on social and intellectual debate. This represented a challenge for a large part of the Macedonian public, opening debates and further analyses on the role of intellectuals in their society. Some critics have questioned his interpretation of existentialism and political engagement, sparking debate about his interpretation and influence on Macedonian society. In conclusion, the reception of Sartre in North Macedonia is an expression of a vibrant relationship between cultures and an example of the profound influence such an intellectual figure can have in a specific cultural context.

Keywords: Sartre, existentialism, literature reception, political engagement, North Macedonia.

Përmbledhje

Jean-Paul Sartre, si përfaqësues kryesor i ekzistencializmit frëng, filloi të lexohet e analizohet nga kritikët dhe studiuesit e letërsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut pas botimit të veprave të tyre në gjuhën serbe e më pas në atë maqedonase. Receptimi filloi me romanin më të njohur të Jean-Paul Sartre-it, duke filluar nga viti 1966, gjegjësisht me romanin *Neveria*. Më pas u përkthyen veprat: *Fjalët*, *Të burgosurit e Altonës*, *Duart e ndyta* dhe *Qenia e Hiçi*.

Mbi dymbëdhjetë punime shkencore flasin për jetën dhe krijimtarinë letrare e filozofike të Sartre-it, duke na dhënë një pasqyrë të thellë mbi trajtimin e tij brenda sistemit kulturor maqedonas. Receptimi i filozofisë së Sartre-it në Maqedoninë e Veriut ka pasur ndikim të thellë në botën akademike dhe kulturor të vendit. Përmes përkthimeve të veprave të tij dhe analizave të gjërë që janë bërë mbi jetën dhe punën e tij, Sartre-u është shndërruar në një nga figurat kryesore të studimeve letrare dhe filozofike në Maqedoni.

Nëpërmjet këtyre studimeve, është ofruar një shkëlqim i vërtetë mbi interpretimin e mendimit të tij dhe ndikimin e tij në shoqërinë maqedonase. Përveç veprave letrare, Sartre-u është njohur edhe për angazhimin e tij politik dhe për ndikimin e tij në debatin shoqëror dhe intelektual. Kjo përfaqësoi një sfidë për një pjesë të madhe të publikut maqedonas, duke hapur debate dhe analiza të mëtejshme mbi rolin e intelektualëve në shoqërinë e tyre. Disa prej kritikëve kanë vënë në pikëpyetje interpretimin e tij të ekzistencializmit dhe angazhimit politik, duke sjellë debat mbi interpretimin dhe ndikimin e tij në shoqërinë maqedonase. Në përfundim, receptimi i Sartre-it në Maqedoninë e Veriut është shprehje e një marrëdhënie të gjallë midis kulturave dhe një shembull i ndikimit të thellë që një figurë e tillë intelektuale mund të ketë në një kontekst kulturor të caktuar.

Fjalët kyçe: Sartre, ekzistencializmi, receptimi letrar, angazhimi politik, Maqedonia e Veriut.

Receptimi i filozofisë së Jean-Paul Sartre-it në Maqedoninë e Veriut

Receptimi i veprave të Jean-Paul Sartre-it, për më shumë se gjysmë shekulli nga vdekja e tij, dëshmon se ishte personaliteti i rëndësishëm i epokës së tij dhe një figurë që mbetet aktuale. Ndërmjet dy luftërave botërore nuk ishte e lehtë të ishte njëherësh filozof, profesor, gazetar, romancier, kritik letrar, dramaturg e biograf, madje edhe njeri i politikës. Si i tillë, ai u quajt “intelektual total” nga ithtarët e kohës. Emri i tij, ndonjëherë, bëhet sinonim i një kohe. Aktualiteti ynë, shkruan Bernard-Henri Lévy, ndonjëherë trajtohet si „shekull i Sartre-it”,⁶ shkaku i ithtarëve të tij, por shihet edhe si një „reflektim” shkaku i kritikëve të tij. Një gjë mund të thuhet: ai ishte njëri nga personalitetet më kontradiktore të shekullit XX. E kjo aspak s’ë cenon talentin e tij. Ai ishte njëri nga intelektualët që guxoi t’i pranonte gabimet e veta. Në kontekstin kulturor shqiptar, ky duhet të jetë një mësim për intelektualin e sotëm.⁷

Angazhimi i Sartre-it, i cili fillimisht ishte gjenerator i kreativitetit të tij, shndërrohet në angazhim social, kurse krijimtaria letrare dhe filozofike kalon në plan të dytë. Për pasojë, asgjë e filluar në krijimtarinë e tij nuk e pa fundin e vet. Sartre-i, si përfaqësues kryesor i ekzistencializmit, me teoritë e tij, sjell shumë risi në rrymën ekzistencialiste të shekullit XX, sikurse janë: ekzistenca i paraprindës; gjërat dhe njerëzit jetojnë në botë nga fakti dhe jo se kanë të drejtë (Neveria); njerëzimi fillon në anën tjetër të dëshpërimit; detyra themelore e njeriut është lufta për liri dhe solidariteti me të shtypurit; të flasësh do të thotë të veprësh, etj.⁸

Veprat e Sartre-it ishin mbi 20 vjet në qendër të vëmendjes së qarqeve letrare të vendeve perëndimore dhe lindore. Veprat janë vlerësuar ndër vite nga kritikët më të njohur letrarë. Disa, që janë frymëzuar nga ai, e quajnë autor gjenial dhe baba të letërsisë bashkëkohore. Shkaku i zgjimit të interesimit për këtë vepër letrare ishte edhe ndarja e çmimit Nobel në vitin 1965, të cilin Sartre-i e refuzoi. Por, para së gjithash, qëndron tek zhvillimi i mendimit të tij filozofik ekzistencialist dhe lufta e tij për një fitore të së mirës dhe paqes në botë.⁹

Në studimet filozofike dhe letrare pika kryesore e fokusimit të tij është subjekti. Sipas këndvështrimit filozofik të Sartre-it, subjekti është i vetmi burim i gjërave dhe s’mundet e nuk bën të thuhet që subjekti është idealist. Romani *Neveria*, që është vepra e tij e parë letrare, vlerësohet si ndër arritjet më të mëdha të letërsisë ekzistencialiste dhe e mbarë letërsisë së psikoanalizës ekzistencialiste. Roquentin, në të vërtetë, është vetë Sartre-i, aq sa disa detaje të librit përputhen me çastet jetësore të autorit.¹⁰

⁶ Bernard-Henri Lévy, *Le Siècle de Sartre*, Grasset, Paris, 2000, f. 115.

⁷ Avdi Visoka, *Koha e shkrimit*, 99-AIKD, Prishtinë, 2011, f. 120.

⁸ Emine Shabani, *Studime letrare*, Arbëria Design, Tetovë, 2017, f. 50.

⁹ Мирјана Чепинчиќ-Јовановска, *Жан-Пол Сартр: Тегобност*. Култура, Скопје, 1966, f. 269.

¹⁰ Ibid., f. 273.

Roquentin dhe Sartre-i e kalojnë kohën e lirë duke shëtitur nëpër vende të ndryshme të botës. Sipas filozofisë sartriane, njeriu çdoherë është i përqendruar në të ardhmen dhe kështu e harron të tashmen. Kur njeriu e kryen një detyrë, vendos një tjetër detyrë para vetes dhe kështu tërë jetën, sapo e kryen një detyrë, ai vazhdon me tjetrën. Duke i realizuar dëshirat dhe ëndrrat e tij, vjen në përplasje me njerëzit tjerë. Sipas Sartre-it, njeriu s'mund të jetë i vetëm. Ai kërkon partner. Zgjedhja është e rastësishme. Pastaj lidhen vetvetiu njëri për tjetrin, ku njeriu bëhet përgjegjës për tjetrin dhe për veprat e tij.¹¹

Receptimi i Jean-Paul Sartre-it në Maqedoninë e Veriut: Një takim kulturor dhe ndikimi intelektual

Krijimtaria e Sartre-it reflektoi edhe në sistemin kulturor maqedonas. Vepra e parë e Sartre-it që u përkthye në gjuhën maqedonase është romani *Neveria*. Kjo veprë u përkthye nga Mirjana Çepinçiq-Jovanovska në vitin 1966, kurse u botua nga shtëpia botuese „Kultura” e Shkupit. Edhe Bozhidar Nastev ndikoi në praninë dhe receptimin e Sartre-it në sferën kulturore maqedonase. Ai në vitin 1962 e përktheu dramën *Të dënuarit e Altonës* (Les séquestrés d'Altona), kurse 10 vite më vonë, në vitin 1972, edhe dramën *Duart e ndyta* (Les mains sales). Kështu, ai i solli lexuesit maqedonas jo vetëm dramën më të mira të Sartre-it, të vlerësuara si ndër veprat më fundamentale të teatrit bashkëkohor francez, por edhe angazhimin e tij si filozof e shkrimtar në proceset bashkëkohore.

Mesazhet e këtyre dy dramave të Sartre-it ndikuan në jetën kulturore maqedonase të viteve '70. Ishte koha kur në shoqërinë maqedonase filloi demitizimi i personalitetit të autorit për t'u fokusuar tek arti i tij.¹² Liljana Todorova, në një punim kushtuar Blazhe Konevskit, shkruan: „Blazhe Koneski i ka pritur në takim edhe autorët Jean-Paul Sartre dhe Simone de Beauvoir në Shkup gjatë vizitës së tyre në vitin 1948”.¹³ Pastaj, në 100 vjetorin e lindjes së Jean-Paul Sartre-it, do t'ia kushtonte punimin me titull „Reflektime nga vepra e Jean-Paul Sartre-it si estetike / filozofie e lëvizjes në hapësirat letrare maqedonase”.¹⁴

Se sa ishte i pranishëm e i rëndësishëm Sartre-i për letërsinë maqedonase të viteve '60, tregon edhe vizita e tij me Simone de Beauvoir-it në Shkup. Më 25 korrik 1956, një gazetar i ri i gazetës *Nova Makedonija*, duke shkuar në punë në mëngjes, kaloi pranë restorantit *Makedonija* në sheshin kryesor të Shkupit. Bashkë me një mik ishte ulur në tavolinën ku përballë kishin një person që në pamje të parë i dukej i njohur, por s'e mbante mend saktësisht se kush ishte.¹⁵ Burri tymoste me elegancë një puro dhe teksa pinte kafënë e mëngjesit foli i qetë me bashkëbiseduesin e tij. Gazetari pyeti veten se kush mund të ishte. Loja e ekspozimit iu duk shumë e ngatërruar, por s'u dorëzua. Ai shpiku diçka më praktike për ta kënaqur kureshtjen.

Që ta zbulonte enigmën, gazetari hyri në hotel dhe i kërkoi recepsionistit të hidhte një sy në librin e të ftuarve. Ai u habit kur recepsionisti i lexoi: Jean Paul Sartre dhe Simone de Beauvoir. Dy emrat e famshëm të kulturës franceze? Po. Por, si ishte e mundur që askush nuk dinte gjë për ata? Ndonëse i hutuar, gazetari telefonoi fotoreporterin e gazetës, Tome Dimovski, për të bërë foto. Njëri nga heronjtë e kësaj historie, ishte gazetari dhe shkrimtari Ilhami Emin, që e kujtoi përgjithmonë ngjarjen. Gjëja e parë që i erdhi në mendje në atë çast ishte ideja që ta thirrte doktor Kiril Kamilovin, një frankofon dhe drejtor i Muzeut Etnologjik.

¹¹ Мирјана Чепинчиќ-Јовановска, *Жан-Пол Сартр: Тегобност*. Култура, Скопје, 1966, f. 275.

¹² Божидар Настев, *Трудови - приредил Луан Старова*, Мисла, Скопје, 1985, f. 34.

¹³ Лилјана Тодорова, *Делото на Блаже Конески во Македонско-Француските лингвистички и книжевни релации*, МАНУ, Скопје, 2002, f. 238.

¹⁴ XXXII Научна конференција на XXXVIII Меѓународен семинар за македонски јазик, литература и култура, Охрид 16-17 август 2005, Скопје, Универзитет „Св. Кирил и Методиј“, 2006; Современост, Скопје, 2006, бр. 2, стр. 51-58.

¹⁵ Данило Коцевски, *Симон де Бовоар и Жан Пол Сартр во Скопје*, Нова Македонија, 16.05.2020.

Pas pak, Kamilov u shfaq duke vrapuar nëpër shesh, i emocionuar nga lajmet që i kishin thënë. Pas një kohe, Kamilovi u kthye dhe hyri në restorantin *Makedonija*, së bashku me kritikun e njohur letrar, profesorin dhe shkrimtarin Dimitar Mitrev. Ata u prezantuan me mirësjellje me Sartre-in dhe Simone de Beauvoir-in dhe biseduan me ta pasi që të dy e njihnin gjuhën frëngjet. Sartre-i ishte i lumtur me qëndrimin në Maqedoni, ku njerëzit ishin të sjellshëm. Ai shprehu dëshirën t'i takonte sërish.

Ata qëndruan shkurt, sepse ishin nisur në një udhëtim në Greqi. Biseda zgjati rreth një orë. „Të nesërmen, më 26 korrik 1956, në gazetë doli lajmi i bujshëm: „Zhan Pol Sartri në Shkup”. I gjithë qyteti fliste për ngjarjen. U bëra popullor brenda natës. Ndonëse nuk isha firmosur nën tekst, të gjithë e morën vesh autorin”, tregon Danilo Kocevski. Profesorja Haralampie Polenakoviç e thirri gazetarin ta përgëzonte. Menjëherë ai u avancua në punën gazetareske. Shtatë vite më vonë, kur tërmeti e goditi Shkupin, pra në vitin 1963, Jean-Paul Sartre shkroi njërin nga tekstet më të mira për qytetin e shkatërruar tragjikisht.¹⁶

Përkthimi i veprave të Jean-Paul Sartre-it në Maqedoninë e Veriut: Në kërkim të receptimit kulturor dhe politik

Përkthimi i veprave letrare dhe filozofike të Sartre-it në Maqedoninë e Veriut u bë në varësi të receptimit politik të Sartre-it e pastaj edhe receptimit letrar. Romani *Neveria*, përveçse nga Mirjana Çepinçiq-Jovanovska, u përkthye në vitin 2004 edhe nga Bllagoja Korubin. Romani u botua nga shtëpia botuese „Vreme” e Shkupit. Përkthimi i fundit i këtij romani është bërë në vitin 2013 nga Ofelija Kovilovska dhe u botua nga „Ars Lamina” e Shkupit. Shumë më vonë, krahasuar me përkthimin në gjuhën shqipe, u përkthye edhe romani *Fjalët* nga Bllagoja Velkovski-Krash.

Ky roman, që në Shkup u botua në vitin 2012, në gjuhën shqipe ishte përkthyer nga Edmond Tupja dhe ishte botuar në Tiranë më 1964. Nga veprat filozofike të Sartre-it janë përkthyer vetëm tre. *Mosha e arsyes* u përkthye më 1968 nga Vera Hristova dhe u botua nga „Makedonska kniga” e Shkupit, kurse më 2009 u përkthye edhe nga Poliksena Matkovska dhe u botua nga shtëpinë botuese „Mikena” e Manastirit. Në vitin 1979 prof. dr. Luan Starova e përktheu pjesën e tretë të *Situatave*, më saktë *Letërsia dhe angazhimi*, që u botua nga „Misla” në Shkup. Vepra *Qenia dhe hiçi* u përkthye në vitin 2019 nga Katerina Jovanova-Kuseski dhe u botua nga „Ars Studio” e Shkupit.

Një trajtim shkencor të veprimtarisë filozofike dhe letrare të Sartre-it e bëri prof. dr. Luan Starova në pasthënien e librit të përkthyer *Letërsia dhe angazhimi*. Sipas tij, qasja e kritikës letrare të tërheq kah vetja, vepra drejt brendësisë së saj, kurse autori duhet të jetë diku në mes. Megjithatë çfarë përjasje duhet bërë për të shkruar në letër aventurën shpirtërore dhe njerëzore të një prej njerëzve më kompleksë e më të paparashikueshëm të kohës sonë – Jean-Paul Sartre-it.¹⁷

Për studimin e jetës dhe krijimtarisë letrare të Sartre-it, prof. dr. Luan Starova u frymëzua nga biseda me piktorin dhe eseistin maqedonas Gligor Çemerski, që e kishte takuar Sartre-in gjatë ditëve studentore në Beograd, ku ishte mahnitur nga prezantimi elokuent i ekzistencialistit francez. Sartre-i është vlerësuar, pranuar e refuzuar si rrallë kush prej autorëve botërorë nga kritikët e dramës dhe ata letrarë. Deri më 1969 në botë ishin shkruar 32 libra për të, ishin mbrojtur 52 disertacione të doktoratës, kurse në Japoni ishin shkruar 84 libra që e trajtonin krijimtarinë e tij, ndërkaq ai ishte i anatemuar nga kisha katolike, e cila e kishte ndaluar leximin e veprave të Sartre-it.¹⁸

¹⁶ Данило Коцевски, *Симон де Бовоар и Жан Пол Сартр во Скопје*, Нова Македонија, 16.05.2020.

¹⁷ Луан Старова, *Литература и ангажман*, Мисла, Скопје, 1979, f. 383.

¹⁸ Ibid, f. 384.

Veprimet e Sartre-it ishin përpjekje madhore si ajo e Sizifit për të nxjerrë në pah sa më shumë nga asgjëja njerëzore, që është e kufizuar nga horizontet e së mundshmes. Në fakt, e gjithë krijimtaria letrare dhe filozofike e Sartre-it, veprimet dhe heshtjet e tij, tentativat e tij për ta prekur *ferrin e të tjerëve*, të arbitronte në gjyqet morale kundër shkaktarëve të luftës në Vietnam, Algjer dhe Angolë, janë pjesë e përpjekjes së tij për të depërtuar sa më thellë te qenia njerëzore, përtej barrierave, miteve e tabuve, kufijve e paragjykimeve të mundshme. Në çdo rresht prej atyre dhjetëra mijëra faqeve të shkruara në letër dhe jo më pak të theksuara, Sartre-i ka peshën e çrënjës së vazhdueshme të njeriut nga hiçi, të kryqëzuar në amplituda e brendshme e të vazhdueshme midis iluzioneve dhe deluzioneve të veta.

Për vlerën dhe peshën e Sartre-it në Francë dhe vendet e tjera të botës shkroi edhe Le Clézio. Sipas tij, letërsia frënge nuk ka pasur ende një aventurë shpirtërore më domethënëse se ajo e Sartre-it. Sipas tij, Sartre-i, në radhë të parë, është hero i shekullit XX, sepse e mishëroi këtë shekull, sepse vuajti në këtë shekull dhe sepse veproi në këtë shekull në mënyrën më të mundshme. Virtyti më i madh i tij ishte se ai thoshte që të shkruhej ajo që duhej shkruar, jo të shtrembërohej e vërteta duke shkruar sipas kërkesave të politikës dhe fuqive të ndryshme të mesit të shekullit XX.¹⁹

Përfundim

Në përfundim, shihet një zhvillim i dukshëm në botimin, leximin dhe përkthimin e veprave dhe ideve të Jean-Paul Sartre-it në Maqedoninë e Veriut. Numri rritës i botimeve dhe përpjekjet për t'u ribotuar tregojnë se ky autor i ekzistencializmit francez ka një ndikim të thellë në audienca të ndryshme në këtë rajon. Veprat ekzistencialiste të Sartre-it përmbajnë elemente si absurditeti, revoltë, dilemat, dhe liria, duke reflektuar realitetet komplekse të shoqërisë dhe individit.

Një nga veçoritë më të rëndësishme është që ato kanë përjetuar interpretim të ndryshëm nga autorë të ndryshëm, duke reflektuar kohëra dhe kontekste të ndryshme historike, kulturore, dhe ideologjike. Temat që trajtojnë janë tërësisht relevante dhe shpesh herë lidhen me çështje të tilla si lufta, vdekja, dashuria, dhe liria. Personazhet janë të portretizuar si figura të ndërjegjshme dhe dinjitoze në një botë tërësisht të shkallësuar dhe të komplikuar. Ekzistencializmi, si një nga elementët kryesore të këtyre veprave, përfaqëson një sfidë për individin për të zgjedhur dhe për të jetuar në një botë ku realiteti është subjekt i shumë interpretimeve.²⁰

Referencat

- [1]. Чепинчик-Јовановска, М. (1966). *Жан-Пол Сартр: Тегобност*. Скопје: Култура.
- [2]. Коцевски, Д. (2020). *Симон де Бовоар и Жан Пол Сартр во Скопје*, Нова Македонија, 16.05.2020.
- [3]. Lévy, В.-Н. (2000). *Le Siècle de Sartre*. Paris: Grasset, 2000.
- [4]. Настев, Б. (1985). *Трудови - приредил Луан Старова*. Скопје: Мисла.
- [5]. Поповска, Е. & Петрова, С. (2020). *Аналогии и интеракции во романистичките проучувања – Зборник трудови посветен на проф. д-р Лилјана Тодорова*, Скопје: УКИМ.
- [6]. Shabani, E. (2017). *Studime letrare*, Tetovë: Arbëria Design.
- [7]. Старова, Л. (1979). *Литература и ангажман*. Скопје: Мисла.
- [8]. Тодорова, Л. (2006). *Книжевни интерференции*, Скопје: Матица македонска.
- [9]. Тодорова, Л. (2002). *Делото на Блаже Конески во Македонско-Француските лингвистички и книжевни релации*, Скопје: МАНУ.
- [10]. Тодорова, Лилјана, *Француските поетички референци*, <http://www.mirage.com.mk/index.php/mk/spisanie-mirage/347-26/komparativni-poetiki/97-2013-04-23-07-39-45>
- [11]. Visoka, A. (2011). *Koha e shkrimit*. Prishtinë: 99-AIKD.
- [12]. Visoka, A. (2016). *Shkrim dhe receptim*. Prishtinë: Faik Konica.

¹⁹ Ibid., f. 388.

²⁰ Emine Shabani, *Studime letrare*, Arbëria Design, Tetovë, 2017, f. 46.